

## KUSHTET E PËRDORIMIT

DEKRA Akademi sh.p.k., me qëllim dhënien e informacioneve që lidhen me aktivitetin e saj të formimit profesional, përdor këtë faqe interneti: [www.dekra.al](http://www.dekra.al).

DEKRA Akademi sh.p.k. synon që informacioni i publikuar në faqen e internetit të jetë i plotë dhe i përditësuar dhe ruan të drejtën e pronësisë për këtë faqe interneti, si dhe për materialet e publikuara në të.

Përdorimi i kësaj faqeje interneti nënkupton pranimin e Kushteve të Përdorimit, të cilat lexohen së bashku me Politikën e Privatësisë dhe janë të aplikueshme në të gjithë përmbajtjen e faqes. Në rast se vizitori/ përdoruesi i internetit nuk është dakord me ndonjë pjesë të këtyre Kushteve, vizitori/ përdoruesi duhet të dalë nga kjo faqe interneti dhe të mos bëjë asnjë përdorim të mëtejshëm të saj.

Ne dëshirojmë t'ju inkurajojmë të lexoni me kujdes kushtet e përdorimit përpara përdorimit të kësaj faqe interneti.

Ju nuk duhet të përdorni këtë faqe në ndonjë mënyrë që mund t'i sjellë dëm faqes sonë ose në asnjë mënyrë tjetër e cila mund të jetë e dëmshme, e jashtëligjshme apo të përbëjë mashtrim.